



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:146502
Datë: 01.03.2024
Numri i dokumentit: 05401705

E.nr.665/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Sh.I. nga Lipjani, të cilën e përfaqëson av Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Shtimes, Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.665/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.665/23, të datës 08.05.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:146502, të datës 14.10.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 19.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit, ta transferoj shumën e mjeteve prej 684.36 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.665/23, më datë 01.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi